



**REPUBLIKA E KOSOVËS /REPUBLIKA KOSOVA/ REPUBLIC OF
KOSOVO
KOMUNA E PRISHTINËS
OPŠTINA PRISTINE/MUNICIPALITY OF PRISHTINË**

**RREGULLORE
PËR MBROJTJEN E TË DREJTAVE TË FËMIJËVE**

Prishtinë, maj 2018

Në mbështetje të nenit 12, paragrafi 12.2, shkronja c, dhe nenit 40, paragrafi 40.2, shkronja a e Ligjit nr. 03/L-040 për vetëqeverisje lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr. 28/04, qershor 2008), dhe të nenit 34, paragrafi 34.1, shkronja c e Statutit të Komunës së Prishtinës, nr. 01-110-391, e dt. 25.02.2010, Kuvendi i Komunës së Prishtinës, në mbledhjen e mbajtur më 28.02.2019, e miratoi këtë

RREGULLORE PËR MBROJTJEN E TË DREJTAVE TË FËMIJËVE

DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

Neni 1

Qëllimi dhe fushëveprimi

1. Kjo rregullore i përcakton procedurat për realizimin e të drejtave të fëmijëve në sistemin e qeverisjes komunale, dhe kontribuon në krijimin e një komune mike për fëmijë.
2. Të gjitha institucionet, shërbimet dhe qendrat për kujdesin dhe mbrojtjen e fëmijëve, të cilat janë në administrimin e Komunës së Prishtinës apo që veprojnë në nivel komunal, veprojnë në përputhje me dispozitat e kësaj rregulloreje.
3. Dispozitat e kësaj rregulloreje vlejnë për të gjithë fëmijët, pavarësisht racës, ngjyrës, gjinisë, gjuhës, fesë, mendimit politik apo ndonjë mendimi tjetër, origjinës kombëtare, etnike apo shoqërore, statusit ekonomik, social, paaftësisë, prejardhjes familjare apo çdo gjendje tjetër të fëmijëve, prindërve apo përfaqësuesve të tyre ligjorë, ashtu sikur është përcaktuar me Konventën për të Drejtat e Fëmijëve.

Neni 2

Fëmija- përkufizimi

1. Fëmijë konsiderohet secili person nën moshën 18-vjeç.
2. Fëmijët janë një kategori e veçantë, të cilët për shkak të moshës dhe pjekurisë së tyre, të drejtat e tyre i realizojnë me mbështetjen e të rriturve.
3. Fëmijët i gëzojnë të gjitha të drejtat, siç parashihen në Konventën mbi të Drejtat e Fëmijëve, dhe në instrumentet dhe standardet e tjera të zbatueshme, që sigurojnë realizimin progresiv të të drejtave të fëmijëve.
4. Për të siguruar mbrojtjen dhe kujdesin e nevojshëm për fëmijën, prindërit, familjet, përfaqësuesit ligjorë dhe institucionet qeveritare e mbajnë përgjegjësinë kryesore për realizimin e të drejtave të tyre, përfshirë mbrojtjen e duhur ligjore dhe administrative.

Neni 3 Parimet e përgjithshme për të drejtat e fëmijëve

1. Konventa e Kombeve të Bashkuara mbi të Drejtat e Fëmijëve, i obligon shtetet që t'i sigurojnë të drejtat e fëmijëve ashtu siç janë përcaktuar në Konventë.
2. Konventa për mbrojtjen e fëmijëve është direkt e aplikueshme në Kosovë, dhe parimet udhëqeqëse përfshijnë:
 1. **Mosdiskriminimin** – që nënkupton se të gjithë fëmijët gëzojnë të drejtat e barabarta, pavarësisht racës, ngjyrës, gjinisë, fesë, mendimit politik, përkatësisë etnike, origjinës kombëtare apo shoqërore, statusit ekonomik të fëmijëve, prindërve apo përfaqësuesit ligjor.
 2. **Interesin më të mirë të fëmijëve** – që nënkupton se të gjitha vendimet që merren nga ana e institucioneve, qoftë publike apo private të përkrahjes shoqërore, nga gjykatat, organet administrative apo organet legjislative, interesi më i lartë i fëmijëve duhet të jetë konisderata kryesore.
 3. **Të drejtën e mbijetesës dhe zhvillimit** – që nënkupton sigurimin e një jete sa më cilësore për fëmijët, jo vetëm në aspektin fizik, por edhe në atë mendor, emocional, shoqëror dhe kulturor.
 4. **Pikëpamjet e fëmijëve** – që nënkupton lirinë e fëmijëve për t'i shprehur pikëpamjet e tyre për të gjitha çështjet që lidhen me ta, si dhe obligimin e institucioneve për t'i dëgjuar pikëpamjet e tyre dhe për t'i marrë parasysh ato, kur marrin vendime me ndikim për fëmijët, në përputhje me nivelin e zhvillimit të fëmijëve.

Neni 4 Komuna mike për fëmijë

1. Komuna mike për fëmijë, ëshë një sistem i qeverisjes së mirë lokale me fëmijën në qendër, e zotuar për zbatimin dhe realizimin e plotë të të drejtave të fëmijëve.
2. Komuna mike për fëmijë, i garanton secilit fëmijë se do të:
 - a. ndikojë apo marrë pjesë në vendimet e komunës që i përkasin;
 - b. shprehë pikëpamjet e veta për komunën;
 - c. marrë pjesë në jetën familjare, të komunitetit dhe në jetën shoqërore;
 - d. pranojë shërbimet kryesore, si kujdesi shëndetësor, arsimi dhe kujdesi alternativ;
 - e. mbrohet nga shfrytëzimi, dhuna, abuzimi apo çfarëdo rreziku tjetër që mund të vije si rezultat i moshës apo pjekurisë;
 - f. ndjehet i sigurtë në rrugë dhe në mjedisin ku jeton;
 - g. ketë në disponim hapësira të mjaftueshme dhe të sigurta për lojëra dhe

argëtim;

- h. ketë qasje në burime të ujit të pastër dhe të ketë qasje në higjienën e duhur;
- i. jetojë në një mjedis të pastër dhe me hapësira të gjelbra;
- j. marrë pjesë në ngjarjet kulturore dhe sociale;
- k. ketë qasje të barabartë në secilin shërbim tjetër të ofruar nga Komuna, pavarësisht racës, gjinisë, fesë, mendimit politik, përkatësisë etnike, origjinës kombëtare dhe sociale, statusit ekonomik të fëmijëve, prindërve apo përfaqësuesve të tyre ligjorë.

Neni 5

Përgjegjësitë për të drejtat e fëmijëve

1. Secili zyrtar publik, secili institucion komunal dhe qendror që vepron në nivel komunal, dhe çdo subjekt tjetër që ndërlidhet me fëmijët, kanë përgjegjësi sociale dhe ligjore për t'u angazhuar në mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të fëmijëve, në përputhje me konceptin e Komunës mike për fëmijë.
2. Palët përgjegjëse për mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të fëmijëve në Komunë, përfshijnë, por nuk kufizohen në:
 1. Zyrën e Kryetarit të Komunës, Kuvendin e Komunës dhe drejtoritë komunale;
 2. Mekanizmat koordinuese për mbrojtjen e fëmijëve në nivel komunal;
 3. Zyrën për të drejtat e njeriut/fëmijëve në komunë;
 4. Qendrën për punë sociale;
 5. Institucionet shëndetësore;
 6. Shkollat, përfshirë të gjitha institucionet publike dhe private të arsimit parauniversitar;
 7. Klubet dhe shoqatat sportive dhe artistike;
 8. Institucionin Avokati i Popullit;
 7. Bashkësitë lokale;
 8. Shoqatat e prindërve;
 9. Organizatat e Shoqërisë Civile;
 10. Zyrat dhe njësitë e organizatave ndërkombëtare në komunë;
 11. Shoqatat profesionale;
 12. Organet tjera, formale dhe joformale, që si qëllim parësor kanë promovimin e mbrojtjes së përgjithshme sociale dhe mirëqenies së fëmijëve;
 13. Këshilli komunal për siguri në bashkësi.

Neni 6

Bashkëpunimi ndërkomunal, ndërinstytucional dhe me organizatat joqeveritare

1. Komuna bashkëpunon me komunat e tjera për të gjitha çështjet që ndërlidhen me mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të fëmijëve.
2. Për të gjitha çështjet që kanë të bëjnë me mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve, në përputhje me legjislacionin në fuqi, Komuna bashkëpunon me institucionet e drejtësisë, policinë, prokurorinë, gjykatat, shërbimin sprovues dhe shërbimin korrektues, si dhe me organizatat joqeveritare.

Neni 7

Mekanizmi koordinues për të drejtat e fëmijëve

1. Kryetari i Komunës nxjerr vendim të veçantë për krijimin e mekanizmave koordinues, sipas nevojës edhe ekipeve apo mekanizmave të tjerë, lidhur me çështjet e të drejtave të fëmijëve në Komunë;
2. Kryetari i Komunës i përcakton kushtet e punës, rolet dhe përgjegjësitë, si dhe rregullat e procedurës së Mekanizmit koordinues, dhe të organeve tjera të krijuara me qëllim të mbrojtje së të drejtave të fëmijëve;
3. Mekanizmi koordinues komunal shërben si një organ për vendosjen e prioritetëve dhe sigurimin e cilësisë për çështjet dhe zgjidhjet për fëmijë, bazuar në ligjet dhe politikat ekzistuese;
4. Mekanizmi koordinues komunal harton planet e veta për zhvillim, ndan buxhete dhe monitoron zbatimin e tyre;
5. Mekanizmi koordinues i përgjigjet drejtpërdrejt kryetarit të Komunës.
6. Detyrat e Mekanizmit koordinues përfshijnë edhe:
 - a. Sigurimin e koordinimit të politikave të cilat ndikojnë te fëmijët;
 - b. Sigurimin e zbatimit të kornizës ligjore për të gjitha çështjet e mbrojtjes së fëmijëve, brenda kompetencave të Komunës;
 - c. Mbështetjen e fuqishme në të gjitha çështjet e fëmijëve dhe ndikimet në legjislacionin dhe politikat e vendit;
 - d. Vetëvlerësimet periodike, të cilat rezultojnë me veprime dhe politika që duhet të ndërmerren nga Komuna, në mënyrë që të krijohet një Komunë mike për fëmijë;
 - e. Udhëheqjen e procesit të hartimit të një strategjie komunale dhe planit të veprimit për fëmijë;
 - f. Rishikimin e zbatimit të planit në baza vjetore, bazuar në vetëvlerësimin komunal;
 - g. Sigurimin e një sistemi komunikimi që mundëson shprehjen e mendimeve të fëmijëve, me pjesëmarrjen e fëmijëve, të cilat përfshihen në punën e qeverisjes në nivel komunal;

- h. Sigurimin e një sistemi komunikimi, që mundëson shkëmbimin e informacionit ndërmjet institucioneve komunale dhe qendrore;
- i. Ofrimin e këshillave dhe rekomandimeve për çështjet e mbrojtjes së të drejtave të fëmijëve;
- j. Koordinimin e të gjithë trupave të tjerë që merren me mbrojtjen dhe të drejtat e fëmijëve.

Neni 8

Vlerësimi i ndikimit të fëmijët

1. Komuna zhvillon procesin për vlerësimin e ndikimit të politikave, legjislacionit, strategjive e planeve të veprimit dhe programeve për fëmijë.
2. Vlerësimi fillon në faza të hershme, gjatë analizës së situatës së fëmijëve dhe ndikimit të ndërhyrjeve tek fëmija, për të marrë vendime bazuar në interesin më të mirë të fëmijës.
3. Komuna në mënyrë të rregullt e bën vlerësimin e ndikimit të aspekteve të qeverisjes lokale të fëmijët.

Neni 9

Sistemi i raportimit të rregullt mbi gjendjen e fëmijëve

1. Mekanizmi koordinues komunal i përcakton treguesit dhe të dhënat, sipas prioriteteve të Komunës për fëmijët dhe interesat e tyre.
2. Komuna i përcakton rolet dhe përgjegjësitë e të gjitha institucioneve komunale për mbledhjen e të dhënave dhe raportimin nga sektorët përkatës, lidhur me qëllimet e zhvillimit të qëndrueshëm.
3. Komuna përmes Mekanizmi koordinues, kërkon nga njësitë përgjegjëse që të raportojnë në mënyrë periodike.
4. Komuna, në mënyrë efektive i shfrytëzon raportet, për të zhvilluar politika, strategji komunale, plane të veprimit dhe buxhetin për fëmijë.

Neni 10

Promovimi i të drejtave të fëmijëve

1. Komuna ndërmerr masa konkrete, në mënyrë që të promovohen dhe respektohen të drejtat e fëmijëve, përmes:
 - i. organizimit të trajnimeve mbi të drejtat e fëmijëve për udhëheqësit dhe zyrtarët komunalë;

- ii. përfshirjes së mësimin për të drejtat e fëmijëve, dhe Konventës për të Drejtat e Fëmijëve në kurrikulën me bazë në shkollë;
 - iii. përfshirjes së mësimin për promovimin dhe respektimin e të drejtave të fëmijëve në kuadër të programeve të trajnimit para dhe gjatë shërbimit, për persona të cilët punojnë me fëmijë ose për fëmijë në nivel komunal.
2. Kuvendi i Komunës organizon të paktën një (1) seancë vjetore, për t'i diskutuar çështjet e të drejtave të fëmijëve, duke iu referuar raportit të situatës për fëmijë, sipas nenit 8, paragrafi 4 i kësaj rregulloreje.
 3. Komuna i organizon dhe i mbështetë "Ditët mike për fëmijë", dhe diskuton çështjet lidhur me të drejtat e fëmijëve.
 4. Komuna bën vlerësimin e rregullt të njohurive për të drejtat e fëmijëve në mesin e të rriturve dhe fëmijëve.
 5. Komuna e bën promovimin e punës së institucioneve, të cilat janë të mandatuara me ligj për promovimin, monitorimin dhe mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve.
 6. Komuna krijon partneritet me institucionet qendrore dhe organizatat dhe institucionet e pavarura, organizatat e shoqërisë civile, grupet e të rinjve dhe mediet për t'i promovuar të drejtat e fëmijëve.
 7. Komuna u ofron mbështetje organizatave të shoqërisë civile, për të zhvilluar kapacitetet e tyre për të ndikuar në vendimmarrjen e pavarur në fushën e të drejtave të fëmijëve.
 8. Komuna i inkurajon dhe i mbështetë organizatat e të rinjve dhe fëmijëve.
 9. Komuna në mënyrë të rregullt komunikon me organizatat e Shoqërisë Civile dhe institucionet e tjera të pavarura, në mënyrë që në komunë të sigurohet një mjedis i sigurt për fëmijët.

Neni 11

Pjesëmarrja e fëmijëve

1. Komuna siguron pjesëmarrje aktive të fëmijëve në rastet që janë me interes për ta, në çdo proces të vendimmarrjes në nivel të komunës. Të gjithë zyrtarët publikë, institucionet dhe njësitë komunale institucionale, janë të obliguara që këtë ta pasqyrojnë në punën e tyre.
2. Institucionet edukative-arsimore e mundësojnë mësimin dhe sigurojnë pjesëmarrje aktive përmes kurrikulës së shkollës dhe aktiviteteve tjera ekstra-kurrikulare, në koordinim me institucionet e sektorëve përkatës, të cilët janë në kontakt të drejtpërdrejtë me fëmijët, përmes ofrimit të shërbimeve arsimore, shëndetësore dhe të mirëqenies sociale.
3. Institucionet edukative-arsimore, kulturore dhe të sportit, e mbështesin krijimin dhe funksionimin e organizatave të fëmijëve dhe të rinjve, klubeve të artit, kulturës dhe sportit.

4. Organet administrative dhe gjyqësore komunale në të gjitha rastet e marrjes së vendimeve që kanë të bëjnë me fëmijët, në mënyrë të plotë, i marrin parasysh pikëpamjet e fëmijëve, në përputhje me praktikën dhe udhëzimet e përcaktuara nga legjislacioni ekzistues.
5. Pjesëmarrja kuptimplote e fëmijëve sigurohet në procesin e vlerësimit të ndikimit të ligjeve, politikave dhe praktikave tek fëmijët: në procesin e raportimit për gjendjen e fëmijëve në komunë; në procesin e buxhetimit për fëmijë dhe në promovimin e të drejtave të fëmijëve në komunë.
6. Për t'u siguruar pjesëmarrja e fëmijëve, Komuna bashkëvepron me Asamblesë komunale të fëmijëve, për të pasqyruar në mënyrë të drejtë opinionet dhe qëndrimet e fëmijëve karshi moshës dhe pjekurisë së tyre.

Neni 12

Pjesëmarrja e fëmijëve përmes Asamblesë komunale të fëmijëve

1. Asambleja themelohet me Vendim të veçantë të Kryetarit të Komunës.
2. Asambleja komunale e fëmijëve, krijohet me qëllimin që, në mënyrë të drejtpërdrejtë, t'i përfaqësojë fëmijët, opinionet dhe pozitën e fëmijëve në komunë dhe në shoqëri.
3. Të drejtat dhe obligimet e Asamblesë komunale të fëmijëve përcaktohen me vendimin, të cilin e nxjerrë Komuna me rastin e themelimit të Asamblesë.

Neni 13

Buxhetimi për fëmijë

1. Komuna zhvillon një proces për analizimin e nevojave të buxhetimit për fëmijët e komunës, bazuar në procesin e vlerësimit dhe raportimit. Ky proces përfshinë:
 - i. analizën e buxhetit të përgjithshëm komunal për të vlerësuar pjesën e shpenzuar për fëmijë dhe sa kanë përfituar fëmijët nga investimet publike të Komunës;
 - ii. ndarjen e përqindjes së nevojshme, bazuar në Planin e veprimit për mbrojtjen e fëmijëve, nga granti i përgjithshëm, të ndarë nga Qeveria për Komunë;
 - iii. analizën adekuate të buxhetit të përgjithshëm komunal dhe elementet brenda tij, në mënyrë që të zbulohet pjesa që është shpenzuar për fëmijë dhe të shfrytëzohen produktet e zhvilluara për të investuar në fëmijë;
 - iv. analizën e ndarjes buxhetore për fëmijë ndër vite dhe tregon trendet e ndarjeve buxhetore për fëmijë.

2. Komuna e planifikon buxhetin komunal, i cili është transparent dhe bazohet në konsultime me palët, duke i përfshirë edhe fëmijët. Ky buxhet i reflekton nevojat për ndarjen e burimeve për fëmijë në të gjitha aspektet e qeverisjes komunale.

DISPOZITAT PËRFUNDIMTARE

Neni 14

Procedurat për zbatimin e Rregullores

1. Mekanizmi i koordinimit, apo ndonjë organ tjetër komunal ose i pavarur, e monitoron zbatimin e kësaj rregulloreje dhe nxjerrë raporte vjetore.
2. Kuvendi i Komunës shqyrton dhe miraton raportin vjetor të mekanizimit koordinues për nivelin e zbatimit të rregullores.
3. Komuna e Prishtinës obligohet që pas hyrjes në fuqi të rregullores, t'i marrë të gjitha masat e nevojshme për krijimin e mekanizmave për zbatimin e saj, ashtu siç parashihet në nenin 6, paragrafët 1 dhe 6, nënparagrafi 6 dhe nenin 8, paragrafi 3.

Neni 15

Hyrja në fuqi

Kjo rregullore hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal, si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në ueb-faqen e Komunës së Prishtinës.

KUVENDI I KOMUNËS SË PRISHTINËS
01-030/01-0048990/19, më 01.03.2019

KRYESUESI I KUVENDIT
Agim Kuleta

